

N.P.SH EUROLINDA

Rr. Dëshmoret e Kombit P.N., 70000 Ferizaj - Kosova

Pronar: Blerim Murati, Nr. i firmës: 811063081

#### 1. Juridiksioni i kushteve të përgjithshme të biznesit

Të gjitha shërbimet e N.P.SH EUROLINDA (më tutje EL) pasojnë vetëm në bazë të kushteve të përgjithshme të biznesit në vijim. Përfshirë nga këto kushte të biznesit janë të vlefshme, vetëm atëherë kur janë bërë si marrëveshje me shkrim dhe janë vërtetuar nga ne, po ashtu me shkrim.

#### 2. Oferta dhe lidhja e kontratës

Ofertat për sistemin online të rezervimit paraqesin kërkesë të detyrueshme për klientin. Me regjistrimin përmes formularit online për rezervim, klienti lidhet detyrimisht gjatë përmbylljes së një kontrate për transport me kushte valide për transportim të EL. Me pranimin nga ana e EL, vjen deri te lidhja e kësaj kontrate për transportim. EL deklaron pranimin e rezervimit, ne rastin kur e dërgon konfirmimin e rezervimit nepermjet një E-maili ose me ngarkimin e kreditkartes tuaj.

#### 3. Kushtet e pagesës

Vlejnë çmimet, të cilat kanë qenë prezente e janë konfirmuar gjatë rezervimit. Paga realizohet vetëm nëpërmes një kreditkarte të pranuar nga EL. Pas pranimit të konfirmimit të rezervimit, i gjithë çmimi i biletës duhet të paguhet, gjë që ndodh dhe me këtë ngarkohet kontoja e kreditkartës së dhënë. Nëse banka ose instituti i kreditkartelave e refuzon pagesën, EL është e autorizuar që ta ndërpresë menjëherë kontratën dhe që ta anulojë rezervimin. Me këtë rast për secilin pasagjer ngrihet pagesa në vlerë prej 30.00 eur, si pagesë që krijohet me përpunimin e rastit.

#### 4. Premtim për konfidencialitet

EL garanton konfidencialitet të plotë për të gjitha të dhënat e pranuar nga klienti.

#### 5. Dokumentet e udhëtimit

Pasagjeri merr nepermjet emailit konfirmimin e rezervimit të cilin e përdor edhe si bilete udhëtimit. Një udhëtim, pa dokument valid për udhëtim, nuk është i pranueshëm. Biletat e aeroplanit, në rastin kur para nisjes shihet se shënimet dhe/ose emri nuk janë të njëjta me të dhënat personale të pasagjerit të dhëna gjatë rezervimit, nuk mund të pranohen si dokumente valide të udhëtimit. Pasagjerët me ndryshime të bëra në biletat e fluturimit/numrat e rezervimit përfshihen nga fluturimi. Për ata vlen çmimi i tërësishëm i biletës. Për rikthimin e biletave, të cilat kanë humbur apo për raste të tjera, të cilat shkaktohen pa ndikimin e EL, ne e ngarisim një shumë për përpunim të rastit në vlerë prej 30.00 eur për secilin biletë fluturimi. Për përbushjen dhe zbatimin e rregullave për hyrje në shtetet tjera, për pasaporta dhe për viza, secilin pasagjer e mban përgjegjësinë për vete. EL është e autorizuar që pasagjerit t'ia llogarisë dhe t'ia vë në faturë çdo shpenzim eventual, që krijohet si pasojë e mospërbushjes së këtyre rregullave.

#### 6. Ndërrim-rezervimi/Anulimet

Ndërrim-rezervimet dhe ndërrimet e emrave mund të bëhen sipas dispozicionit dhe pas pagesës së një shume të caktuar për ndërrim-rezervim, gjegjësisht për anulim dhe ato mund të bëhen me shkrim nga larg e afër, si dhe me gojë, me dhënie e numrit të rezervimit para ditës së fluturimit, gjatë orarit të punës në numrat e telefonit, faksit apo tek adresa që gjendet në faturë/konfirmimin e rezervimit.

Anullimet e fluturimit behen të mundura vetem me kerkes me shkrim Email ( info@eurolinda.net ) ne dite pune deri ne oren 18:00. Anullimet te cilat behen te djelave ose dite festash perpunohen ditën e pare te punes. Per anulim merret parasysh vetem dita ne te cilen EL e merr ketë kerekë.

#### Anullimet:

- 48 ore para fluturimit: 50.00 eur per çdo pasagjer

- 24 ore para fluturimit: 100.00 eur per çdo pasagjer

- me pak se 24 h para fluturimit: 100% të çmimit të biletës.

Për anulime në ditën e fluturimit, llogaritet çmimi i tërësishëm i biletës (100% i çmimit të biletës). Për mosparaqitje në udhëtim (No Show) llogaritet i tërë çmimi i biletës.

#### Ndërrim-rezervimet:

Për ndërrim-rezervim llogaritet shuma prej 50.00 eur. Po ashtu e aplikueshme është përveç 50 eur. për ndërrim date edhe tarifa e biletës për kohën të cilën e bëni rezervimin.

Ndërrimet e emrave pasi të ketë kaluar koha e dita e fluturimit nuk pranohen.

#### 7. Koha për Check-in

EL i këshillon pasagjerët që të paraqiten tek sporteli përkatës për paraqitje të pasagjerëve më së voni 120 minuta para nisjes. Përgatitja e pasagjerëve mbyllet 40 minuta para nisjes së aeroplanit. EL nuk mban përgjegjësi për paraqitje të mëvonshme. Pasagjeri është vetë përgjegjës për arrijtjen me kohë të aeroplanit, për fluturimet tjera lidhëse dhe shërbimet me pagesë që marrin/presin udhëtarët.

#### 8. Konfirmimi i kthimit

Çdo klient i EL është i detyruar ta konfirmojë kthimin e tij të planifikuar brenda 24 deri 48 orëve, nëpërmjet telefonit tek EL. Konfirmimet e kthimeve mund të bëhen në numrat e telefonit që gjenden në biletë. Nëse nuk e konfirmimi kthimin dhe ai ju humb, atëherë shuhet e drejta për fluturim.

#### 9. Bagazhi dhe dokumentacioni

Limiti i lejuar për bagazh për secilin pasagjer (asnjë bagazh i lejuar për foshnje) që paguan është 20. Nuk është e mundur që bagazhin e pasfrytëzuar ta bartni tek pasagjerët tjerë. Vetëm pasagjerët, të cilët kanë rezervuar njëkohësisht bashkë, mund t'ia vendosin bashkërisht limitet e tyre të lejuara për bagazh. Bagazhi me mbipeshë mund të transportohet pas kryerjes së pagesës së paraparë, sipas tarifave për bagazh me mbipeshë. Marrja me vete e mbipeshës nuk mund të garantohet. Për përbushjen dhe zbatimin e rregullave për hyrje në shtetet tjera, për pasaporta dhe për viza, secilin pasagjer e mban përgjegjësinë për vete. Pasagjeri duhet të marrë vetë përsipër çdo shpenzim eventual, që krijohet si pasojë e mospërbushjes së këtyre rregullave.

#### 10. Lirime për fëmijë dhe të rinj

Fëmijët deri në 2 vjeç (pa të drejtë kërkesë për ulëse) dhe të rinjtë deri në moshën 11 vjeçare paguajnë një çmim më të lirë. Me rëndësi është mosha e fëmijës gjatë nisjes. EL e ka të drejtën që para nisjes ta kontrollojë moshën e fëmijës dhe ta ngritë tarifën përkatëse.

#### 11. Tjetërsimi

Tjetërsimet e kërkesave kundër EL janë të paefektshme.

#### 12. Reklamimet

Reklamimet mund të bëhen në mënyrë të shkruar menjëherë pas përfundimit të fluturimit tek adresa në vijim: "N.P.SH EUROLINDA"

Kundërservice: Rr. Dëshmoret e Kombit P.N., 70000 Ferizaj - Kosova

#### 13. Vendi i arbitrazhit

Vendi i arbitrazhit është Ferizaj.

#### 14. Klauzola salvatoriane

Në qoftë se klauzola të veçanta të rregulloreve të dala janë tërësisht apo pjesërisht të paefektshme, atëherë validiteti i rregulloreve të tjera mbetet i paprekur nga kjo. Rregullorja e paefektshme zëvendësohet me një rregullore, e cila për nga qëllimi dhe kuptimi i rregullores së paefektshme është më e përafërt juridikisht dhe ekonomikisht.

#### 15. Qëndrimi

Këto kushte i përkasin qëndrimit të datës 01.01.2024.

N.P.SH EUROLINDA

811063081

Rr. Dëshmoret e Kombit P.N.

70000 Ferizaj

Kontakt:

E-Mail: info@eurolinda.net

Web: www.eurolinda.net

Tel: +383 290 324 093

Cel: +383 44 496 118

Cel: +383 49 833 449

Te dhenat bankare - EUROLINDA

Banka: NLB BANK - EUR/CHF

SWIFT CODE: NLPR XK PR

IBAN: XK05 1703 0010 1253 6457